

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL- GJILAN**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr1 i prokurimit	651-23-13546-5-1-1
Nr i brendshëm	GL 651 23 159 511

Sa i përket tenderit për: **“Renovimi i Stadiumit të Qytetit të Gjilanit”.**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

NNP CONTRUCTION & BENI CONSTRUCTION SH.P.K. & DOMID SH.P.K.& 2A GROUP SH.P.K. & 2T SH.P.K.-DEGA NË KOSOVË

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Ratkoc

(Adresa)

Rahovec

21000

(Vendi)

(Kodi postar)

049/514/500

N/A

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Defrim Morina

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

morina.cons@gmail.com

(Adresa elektronike)

18.06.2024

(Data e parashtrimt të ankesës)



(Nënshkrimi dhe vila)

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për Kontratë: 07.12.2023

Data e hapjes së ofertave: 14.03.2024

Njoftimi mbi vendimin e AK-së: 31.05.2024

Kërkesa për rishqyrtim dt:05.06.2024

Vendimi mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim dt:10.06.2024

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

☐

Jo

☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

☒

Jo

☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

☒

Jo

☐

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së

Neni 6 i LPP-së

Neni 7 i LPP-së

Neni 10 i LPP-së

Neni 11 i LPP-së

Neni 52 i LPP-së

Neni 56 i LPP-së

Neni 59 i LPP-së

Neni 60 i LPP-së

Neni 60 i LPP-së

Neni 69 i LPP-së

Neni 40 i rregullores nr.001/2022 Për prokurim Publik

**** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.**

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Ne kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-së me dt.31.05.2024, ku është rekomanduar për kontratë grupi i OE "Demiri Gartenbau GmbH; AVAG Group SH.P.K.; EL-BAU SH.P.K.; Bujar Shabani B.I.; KOSOVA ASFALT SH.P.K.; K.N.T.SH. Teuta-M SH.P.K.", ndërsa neve na është dërguar letra standarde për tenderues të eliminuar.

Arsyet e eliminimit janë: Mos vendosja e çmimit në paramasë

Një udhëheqës i punishtes-Inxhinier I diplomuar ose master i Arkitekturës, i certifikuar me FIDIC dhe i certifikuar për auditim të energjisë në ndërtesa sipas standardit DIN EN 16247, me minimum 5 (pesë) vite përvojë pune nga data e diplomimit. Duhet të ketë udhëhequr së paku një kontratë të natyrës së ngjashme-ndërtim i lartë ose ndërtim i ulët.

Anita Sadikaj udhëheqëse e punishtes nuk i është nënshtruar vlerësimit dhe provimit për tu kualifikuar me aftësitë profesionale sipas programit për certifikimin Menaxher i Certifikuar i Kontratës me Fidic.

AK e ka cekur se kërkesa e dosjes së tenderit ka qenë të paraqitet certifikata për certifikimin me FIDIC me anë të së cilës dëshmohej se inxhinieri në fjalë është i certifikuar me kualifikimin e njohur ndërkombëtarisht me FIDIC.

Për punëtorët e profileve të ndryshme, autoriteti e ka cekur si arsye të eliminimit faktin se punëtorët e prezantuar i kanë ndjekur trajnimet online dhe jo në pjesën praktike e cila është obligative.

Arsyeja e lartcekur është në kundërshtim me nenin 56.3 të LPP-së, pasi që në kërkesë nuk është specifikuar se a duhet të mbahet trajnimi online apo punëtorët duhet të paraqiten fizikisht.

Në lidhje me arsyet e eliminimit, ju sqarojmë si më poshtë:

- Sa i përket arsyes së parë të eliminimit, ku është cekur se nuk kemi dhënë çmim në pozicionin E.15.8, sqarojmë se pozicioni në fjalë ka të bëjë me Materiali të imët të paspecifikuar copë 1 dhe njësia paushall.

Fillimisht, sqarojmë se ky pozicion nuk ka të specifikuar se për çfarë materiali bëhet fjalë dhe për çfarë materiali duhet të jepet çmimi, ku sasia është përcaktuar 1, prandaj formulimi i këtij pozicioni është shumë i paqartë, i përgjithshëm dhe i pa konkretizuar.

Në pozicionin E.15.8, nuk ka të dhëna konkrete dhe specifikime se çfarë materiali duhet të furnizohet. Ky pozicion realisht mund të keqpërdoret gjatë implementimit të kontratës, pasi që nuk mundet realisht të përcaktohet materiali i pa specifikuar, thjesht duhet të parashtrohet një pyetje se çka konsiderohet material i paspecifikuar?

Pra, mund të keqpërdoret buxheti me këtë formulim kështu që të këtij pozicioni, pasi që mbetet në diskrecion të përfaqësuesve të autoritetit kontraktues të bëjnë definimin e materialit të imët të pa specifikuar, e në këto raste vjen në shprehje mundësia e subjektivizmit dhe e keqpërdorimit të këtij pozicioni, ku mund të faturohen shumë sasi e pa u definuar fare.

Me këtë përshkrim, nuk mund të sigurohet askush, se ky pozicion do të implementohet, prandaj nuk ka rëndësi fare çmimi në këtë pozicion, se a ka apo nuk ka çmim. Madje ky pozicion më tepër shihet si lojë e AK-së.

Pozicione të tilla të pa specifikuara janë edhe pozicioni E.11.2.36, E.13.16, E.14.11.

Këtë përpilim të paramasës, ne e shohim si lojë të AK-së, që nëse nuk do të kishte mundësi të shpallej fitues OE i preferuar i AK-së, atëherë të anulohet ky tender me arsyetimin se në pozicionet e lartpërmendura nuk janë specifikuar punët, shërbimet apo furnizimet që do të kryhen dhe se nuk dihet se si të bëhet faturimi për këto punë, shërbime apo furnizime.

Përderisa nuk është specifikuar saktë në pozicionin E.15.8, se për çfarë materiali duhet të ofrohet çmim dhe përderisa nuk ka definim të qartë për këtë pozicion, atëherë mos ofrimi i

çmimit nga ana jonë, nuk përbën ndryshim substancial dhe material në këtë tender, kështu që mund të konsiderohet devijim i vogël sipas nenit 59.4 pika (ii).

Për më tepër, mund të konsiderohet devijim i vogël ky fakt, kur kem parasysh faktin se nuk dihet a do të ketë ndonjë furnizim të këtij materiali siç është quajtur material i paspecifikuar i imët, prandaj duke pasur parasysh këtë fakt, rezulton se ne jemi eliminuar pa bazë ligjore.

Gjithashtu devijimet e vogla merren në konsideratë kur ka diferencë të çmimit ndërmjet fituesit dhe ankuesit, e që në këtë rast ne jemi më të lirë se sa grupi i OE të rekomanduar për kontratë në vlerë prej **1,723.088 €**.

Kjo diferencë e çmimit është jashtëzakonisht e madhe, prandaj nëse nuk gjen zbatim neni 59.4 pika (ii) e LPP-së në këtë rast, atëherë devijimet e vogla nuk kanë hapësirë të përdoren në asnjë rast tjetër.

Raste të tilla, kur nuk janë dhënë çmime, e që nuk kanë qenë të qarta dhe të sigurta se a do të ketë porosi apo implementim eventual të atyre pozicioneve, janë sqaruar dhe vendosur edhe me vendime të OSHP-së, siç është vendimi **PSH.nr.187/21, 190/21**.

- **Sa i përket arsyes së dytë të eliminimit**, në lidhje me Anita Sadikaj – udhëheqëse e punishtes e caktuar nga ne, sqarojmë se sipas kërkesës së FDT-së ne kemi ofruar dëshminë/certifikatën e trajnimit për këtë inxhinierë e lëshuar nga FIDIC Academy.

Kërkesë në FDT ka qenë:

b)Një udhëheqës i punishtes-Inxhinier I diplomuar ose master i Arkitekturës, i certifikuar me FIDIC dhe i certifikuar për auditim të energjisë në ndërtesa sipas standartit DIN EN 16247, me minimum 5 (pesë) vite përvojë pune nga data e diplomimit. Duhet të ketë udhëhequr së paku një kontratë të natyrës së ngjashme-ndërtim i lartë ose ndërtim i ulët.

Është kërkuar i certifikuar dhe ne kemi prezantuar certifikatën për znj. Anita Sadikaj sipas kërkesës, pavarësisht se tek dëshmia e kërkuar dokumentare, nuk është kërkuar certifikatë. Pretendimi i AK-së se e njëjta nuk i është nënshtruar vlerësimit dhe provimit për tu certifikuar për menaxher të certifikuar të kontratës FIDIC, është pretendim joprofesional dhe i pabazuar, prandaj sqarojmë se kërkesa ka qenë e qartë, **i certifikuar me FIDIC** dhe ne konform kësaj kërkesë kemi ofruar dëshmi certifikatën e lëshuar nga FIDIC Academy.

Duke pasur parasysh këto fakte dhe dëshmi rezulton se ne e kemi plotësuar kërkesën plotësisht, ndërsa AK-së ka vepruar në kundërshtim me nenin 56.3 të LPP-së kur na ka eliminuar për një kërkesë që nuk ka qenë e precizuar në dosje të tenderit.

Nëse eventalisht ka pasur ndonjë dilemë në lidhje me certifikimin atëherë autoriteti kontraktues ka mundur sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së të kërkojë sqarime shtesë.

- **Në lidhje me arsyen e tretë të eliminimit** përkitazi me certifikimet e për dy armirues, dy latues, dy murator, dy suvatues, dy molera, dy shtrues pllakash, dy instalues për instalime elektrike, dy instalues për ujësjellës dhe kanalizim, ju sqarojmë se për të gjithë këta punëtorë kemi ofruar certifikatat konform kërkesës së FDT-së, prandaj arsyeja e eliminimit është e pabazuar dhe e paqëndrueshme.

Tek neni 9.1&9.2 i FDT-së kërkesa 2 pika gj është kërkuar si në vijim:

gj)OE duhet të prezantoj punëtorë të profileve të ndryshme, të certifikuar nga një Institucion i Republikës së Kosovës që posedon qendrën e trajnimit për këto lëmi ose nga një kompani e licencuar, së paku nga dy armirues, dy latues, dy murator, dy suvatues, dy molera, dy shtrues pllakash, dy instalues për instalime elektrike, dy instalues për ujësjellës dhe kanalizim .

Ndërsa dëshmi e kërkuar dokumentare është kërkuar:

gj)çertifikata e noterizuar (noterizimi të prezantohet nga vetë Personi i çertifikuar te noteri) cv, kontrata e punës me ofertuesin dhe përvoja e punës minimum 3 (tri) vite pas çertifikimit.

Arsyetimi i AK-së, se janë ofruar certifikatat për kurse të trajnimit online është arsyetim i pa bazuar dhe i pambështetur në kërkesat e dosjes së tenderit, pasi që në kërkesë të FDT-së nuk është kërkuar që trajnimet të jenë mbajtur me prani fizike të punëtorëve përkatës, prandaj arsyeja e eliminimit është në kundërshtim me nenin 56.3 të LPP-së, sepse nuk mund të eliminohemi për një kërkesë e cila nuk ka qenë e përcaktuar në dosje të tenderit.

Thjesht është kërkuar çertifikata dhe ne kemi ofruar certifikatat, prandaj me rëndësi është se ne kemi ofruar dëshmitë sipas kërkesës. Madje edhe po të ishte kërkuar trajnimi me prani fizike, e po të ishte mbajtur online edhe ky fakt do të konsiderohej devijim i vogël, pasi që me rëndësi është të jenë të çertifikuar punëtorët dhe me rëndësi është se i kanë ndjekur trajnimet, ndërsa forma a e ndjekjes së trajnimit është element i parëndësishëm.

Ne kemi kërkuar qasje në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë, dhe AK-së nuk ka treguar korrektësi dhe transparencë në kërkesën për qasje, duke na shtyrë me forma dhe variante të ndryshme qasjen në dokumente, ndërsa në momentin që na është lejuar qasja, përsëri kanë treguar arrogancë dhe nuk na kanë lejuar qasje të plotë në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë.

Grupi i OE të rekomanduar për kontratë ka plotësuar Aneksin 3 të dosjes së tenderit me kërkesë që për sekret afarist të dokumenteve të mbeten dokumentet e nenit 68 dhe 69 të LPP-së dhe ka bërë një përshkrim të deklaratës, mirëpo në asnjë mënyrë nuk është arsyetuar se përse duhet të jenë sekret afarist këto dokumente dhe në asnjë mënyrë nuk ka arsyetuar se si mund të dëmtohen interesat e kompanisë në fjalë nëse zbulohen dokumentet e tilla.

Me këtë rast nuk është respektuar neni 10 i LPP-së, kurse AK-së nuk ka përgatit versionin e pastruar siç parashihet në nenin 11.4 të LPP-së, prandaj me këtë rast AK-së e ka shkelur edhe nenin 11 të LPP-së.

Në raport/procesverbal të qasjes është shënuar se i janë dhënë kontratat dhe referencat, mirëpo ky konstatim nuk qëndron, pasi që na janë dhënë vetëm lista e kontratave. Këtë fakt e kemi konstatu në procesverbal, ku e kemi shënuar me dorë se çfarë dokumente na janë dhënë e cilat jo.

Duke pasur parasysh që nuk na është lejuar qasa e plotë në dokumentacion, ne do të ngritim pretendime duke pasur për bazë njohuritë që i kemi në lidhje me kompanitë në konsorcium dhe kapacitetet që mund ti kenë.

- Dyshojmë që konsorciumi i rekomanduar për kontratë nuk e ka ofruar Deklarata nga

Banka për qasje në kredi të pa kushtëzuar dhe se nuk ka mjete të gatshme në llogari në vlerën e kërkuar.

“Kërkesa 2.Kapital të mjaftueshëm për realizimin e kontratës (Mjete të gatshme në xhironllogari nga kompania në bankë në vlerë prej së paku : 3,000,000,00 ose qasje në kredi te pa kushtëzuar, nga një bankë duke emërtuar projektin për te cilin lejohet kredia”.

Dëshmia 2. Deklaratë nga banka që dëshmon se OE ka mjete të gatshme në xhirollogari ose qasje në kredi të pakushtëzuar, dokumenti të jetë origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni.

Duke pasur parasysh këtë kërkesë dhe duke pasur njohuri të përgjithshme për këtë konsorcium, pretendojmë se kjo kërkesë nuk është përmbushur në asnjë mënyrë, pra pretendojmë se deklarata nga banka nuk është qasje e pakushtëzuar në kredi, prandaj ky OE është i papërgjegjshëm. Mjete në llogari nuk kanë asnjëri prej anëtarëve të konsorciumit, pasi që është vlerë shume e madhe.

- **Pretendimi i dytë** është se Inxhinierat nuk janë konform kërkesave dhe nuk janë të punësuar sipas ligjeve në fuqi të Republikës së Kosovës.

Nga njohuritë që kemi për anëtarët e konsorciumit dyshojmë se disa inxhinier të angazhuar nga këto kompani, punojnë në institucione të ndryshme, e dyshojmë që punojnë edhe në Komunë të Gjilanit, prandaj këta inxhinierë gjenden në konflikt interesi dhe nuk mund të angazhohen në këtë projekt. Po ashtu inxhinierët që janë në marrëdhënie të rregullt pune nuk mund të punojnë edhe në këto projekte siç është ky, sepse duhet angazhim primar në këtë projekt.

- **Pretendimi i tretë** është se Pajisjet i mungojnë apo nuk janë sipas kërkesave të aneksit 7 të dosjes së tenderit.

ANEKSI 7. Lista - PAJISJET DHE MEKANIZIMI I NEVOJSHËM

Vërejtje: Mbetet obligim i Kontraktorit që, përveç pajisjeve dhe makinerive të listuara më poshtë, të sigurojë edhe pajisje dhe makineri tjera për të cilat kontstohet (nga Autoriteti Kontraktues apo vet Kontraktori) se janë të nevojshme për ekzekutimin e punëve sipas sasisë, cilësisë dhe dimaiks së kontraktuar.

PAJISJET DHE MEKANIZIMI I OBLIGUESHËM PËR PROJEKTIN ME TITULL:

Nr.	Lloji i mekanizimit dhe pajisjeve	Sasia e kërkuar (cope)	
1	Eskavator minimum 5 -10 ton	2	
2	Eskavator minimum 20t	1	
3	Kamion kiper me peshë bartëse minimum 10t	3	
4	Kamion vetshkarkues me kran peshë bartëse 2-3 ton	1	
5	Kamionet kiper me peshe totale max 7 ton	2	
6	Autofshise speciale për pastrim pas perfundiumit te punëve me peshë deri në 1- 3 Ton	1	
7	Rrethoja montuese per sigurimin e punishtes min.200m ²	200m ²	
8	Panele (dërrasa) për kallëpim,	1000m ²	
9	Panele me korniza metalike për kallëpim	1000m ²	
10	Skele	700m ²	
11	Pompë e ujit	1	
12	Cylinder, minimum 8t	1	
13	Cylinder, minimum 2.5-3t	1	
14	Makin per suvatim	1	
15	Vinq kolone (statik)	1	
16	Paisje gjeodezike	1	
17	Damper 1-3 ton	1	
18	Damper mbi 3 ton	1	
19	Kamion per terheqjen e ujerave fekale/zhbllokimin e kanalizimeve me peshe bartese min 13.000 kg	1	

Kërkojmë që të verifikohen të gjitha dëshmitë për pajisjet e lartpërmendura, pasi që dyshojmë që dëshmitë nuk janë ofruar për këto pajisje apo disa dëshmi nuk janë konform kërkesave të lartcekura. Nuk janë ofruar DUD, ose kontrata për të dëshmuar që këto pajisje i plotësojnë kërkesat e dosjes së tenderit. Dyshojmë se tonazha e ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë nuk janë sipas kërkesave të specifikuara.

- Dyshojmë se nuk janë ofruar dëshmi për kërkesat e nenit 9.1&9.2 të FDT-së pika kërkesa Nr.1, pra që nuk ka ofruar kontrata sipas natyrës dhe kërkesës së dosjes së tenderit

dhe në vlerën e kërkuar.

- Dyshojmë se nuk janë ofruar dëshmi për kërkesat e nenit 9.1&9.2 të FDT-së kërkesa Nr.2, pika a, b, c, d, e, ë, f, g, gj, h. Pra dyshojmë se nuk janë ofruar dëshmitë sipas kësaj kërkesë.

- Dyshojmë se nuk janë ofruar dëshmi për kërkesat e nenit 9.1&9.2 të FDT-së kërkesa Nr.3, ku është kërkuar:

Kërkesa 3. OE të ketë një Lead Auditor sipas kërkesës së standartit ISO 9001, dhe i njejti duhet të jetë i Certifikuar edhe për Siguri dhe Shëndet në punë, si dhe të jetë i trajnuar për Eskpert i mjedisit.

Dëshmia 3.Kontrata ose parakontrata e punës, Diplomat ose certifikatat. Cv

Kërkojmë që të verifikohen dëshmitë a janë sipas kërkesës.

- Dyshojmë se nuk janë ofruar dëshmi për kërkesat e nenit 9.1&9.2 të FDT-së kërkesa Nr.4, ku është kërkuar:

Kërkesa 4.Vlersimi i rriskut per kompani nga nje kompani e licencuar.

Dëshmia 4.Vlersimi i rriskut per kompani nga nje kompani e licencuar nga organi kopotent konform ligjit 04 L-161 (MPMS].

Kërkojmë që të verifikohen dëshmitë a janë sipas kërkesës.

- Dyshojmë se nuk janë ofruar dëshmi për kërkesat e nenit 9.1&9.2 të FDT-së kërkesa Nr.5, ku është kërkuar:

Kërkesa 5.Operatori Ekonomik duhet te kete Bazë per beton nga nje kompani e licencuar ose marreveshje per furnizim.

5.Licenca apo leja e vlefshme e lëshuar nga Agjensioni për miniera dhe minerale kopje ose marrveshje per furnizim me OE e licencuar te jete origjinal ose e noterizuar nga orgjinali dhe per kete projekt).

Kërkojmë që të verifikohen dëshmitë a janë sipas kërkesës.

- **Dyshojmë se nuk janë ofruar dëshmi për kërkesat e nenit 6.4 të FDT-së kërkesa Nr.2 dhe 3, ku është kërkuar:**

2. Një vërtetim nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit. Kërkohet kopja vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues.

3. Një vërtetim nga Gjykata qe vërteton se a. Operatori ekonomik, ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kaluar nuk a është shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale; dhe b. Operatori ekonomik nuk është ne falimentim ose nën administrim te dhunshëm gjyqësore. Për piken (a) dhe (b) Kërkohet origjinali vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. Dështimi i Operatorit Ekonomik qe është propozuar qe te shpërblehet me kontrate te sjelle dokumentet te kërkuara ne piken, 2 dhe 3 i jep të drejtë Autoritetit Kontraktues qe ofertën ta refuzoj, te konfiskoj sigurimin e tenderit nëse e njëjta është kërkuar, të inicioj procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-se dhe te vazhdoj me shpërblim te kontratës me Operatorin Ekonomik qe është listuar ne vendin e dyte.

Kërkojmë që të verifikohen se a kanë ofruar vërtetime të ATK-së të gjithë OE në konsorcium dhe a janë pa obligime tatimore.

Po ashtu kërkojmë që të vërtetohen se a janë ofruar vërtetimet e Gjykatës sipas kërkesës së lartpërmendur.

Vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim e kemi pranuar me dt.10.06.2024.

Fillimisht AK-së, është munduar të na cilësojë si palë pa interes në këtë aktivitet të prokurimit sipas nenit 4.1.26 të LPP-së, mirëpo ne sqarojmë se ligjërisht jemi palë me interes në këtë aktivitet të prokurimit, pasi që kemi ofertu në këtë tender dhe oferta jonë është plotësisht në harmoni me kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, përjashtimisht me devijime të vogla por që këto janë të kalueshme sidomos kur kemi parasysh çmimin ofertues në krahasim me OE e rekomanduar për kontratë. Pra ne jemi konkurrues për nënshkrim të kontratës, e po tentohet të cilësohemi si palë pa interes.

Në lidhje me mos ofrimin e çmimit për pozicionin E.15.8, autoriteti kontraktues ka konstatuar se në këtë rast duhet eliminuar pa kërkuar sqarime sipas nenit 10.1 të Udhëzuesit për prokurim Publik Nr.001/2023.

Në këtë rast autoriteti kontraktues i është referuar gabimisht udhëzuesit, pasi që në këtë rast nuk ekziston mos plotësim i listës së çmimeve, por është rast më specifik sepse bëhet fjalë për një pozicion i pa definuar dhe i papërcaktuar dhe ka të bëjë me Materiali të imët të paspecifikuar copë 1 dhe njësia paushall. Në këtë rast nuk mund të përdoret neni 10.1 i udhëzuesit për prokurim Publik Nr.001/2023 sepse nuk përkon me këtë rast i cili është specifik. Ky rast ka të bëjë me devijime të vogla sipas nenit 59.4 pika (ii) të LPP-së.

Pretendimi i AK-së se pozicioni në fjalë ka qenë i ditur qysh nga data 07.12.2023 e jo nga data e parashtrimit të kërkesës për rishqyrtim dhe sqarimi i dosjes së tenderit është përgjegjësi e operatorëve ekonomik, është pretendim i pasaktë dhe jo i qëndrueshëm, pasi që fillimisht duhet marr përgjegjësinë vetë autoriteti kontraktues për përpilimin e kërkesave dhe para masës e jo të bëhen përgjegjës kompanitë ofertuese.

Me këtë përgjigje po vërtetohet saktë loja e AK-së me këtë pozicion dhe me disa pozicione të tjera, që janë lënë me qëllim të pa definuar, për ti përdorur këta pozicione si shkas për anulim të tenderit, nëse nuk do të rezultonte fitues kompania e favorizuar nga AK-së.

Për pozicionet që janë të pa definuar nuk mund të faturohen saktë punët, furnizimet apo shërbimet dhe ekziston rreziku shumë i madh që gjatë implementimit të kësaj kontrate të keqpërdoren këto pozicione dhe të dëmtohet buxheti i Komunës. Ky rast me këto pozicione E.11.2.36, E.13.16, E.14.11, rezulton që të jetë një shkelje ligjit e pariparueshme dhe që nuk mund të ndalohet, e që në kushte normale shpie në anulim të tenderit.

Në lidhje me certifikatën FIDIC për udhëheqësen e punishtes znj. Anita Sadikaj, autoriteti kontraktues vetëm e ka përsëritur arsyen e eliminimit duke thënë se certifikimi me FIDIC përfshinë një proces vlerësimi dhe provimi, mirëpo nuk ka mundur të dëshmojë të kundërtën e asaj që ne kemi sqaruar dhe vërtetuar se dëshmitë për znj. Anita Sadikaj janë sipas kërkesës së FDT-së.

Edhe sa i përket pretendimit tonë ankimor se për dy armirues, dy latues, dy murator, dy suvatues, dy molera, dy shtrues pllakash, dy instalues për instalime elektrike, dy instalues për ujësjellës dhe kanalizim, kemi ofruar certifikatat konform kërkesës së FDT-së, autoriteti kontraktues vetëm e ka përsëritur arsyen eliminimit se janë ofruar certifikatat për kurse të trajnimit online.

Sqarojmë edhe njëherë se në FDT nuk është kërkuar që trajnimet të jenë mbajtur me prani fizike të punëtorëve përkatës, prandaj arsyeja e eliminimit është në kundërshtim me nenin 56.3 të LPP-së, sepse nuk mund të eliminohemi për një kërkesë e cila nuk ka qenë e përcaktuar në dosje të tenderit.

Në lidhje me pretendimin tonë ankimor, se nuk na është lejuar qasje e plotë në dokumentacion të grupit të OE të rekomanduar për kontratë, autoriteti kontraktues pohon se na është lejuar qasje e pakufizuar, mirëpo ky konstatim i AK-së është i pasaktë dhe i paqëndrueshëm.

AK-së e ka cekur se OE i rekomanduar për kontratë i ka përmbushur të tri kushtet për sekret afarist sipas nenit 11.3 të LPP-së, mirëpo sqarojmë se ky konstatim është i paqëndrueshëm, pasi që grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk ka argumentuar me arsye se si mund të dëmtohet materialisht nëse zbulohen dokumentet sipas nenit 68 dhe 69 të LPP-së.

Në këtë përgjigje, autoriteti kontraktues është shumë kundërthënës, pasi që në njëërën anë pohon se është lejuar qasje e plotë në dokumentet që nuk janë sekret afarist, në anën tjetër potencon se i ka lejuar OE ankues që të shikoj me sy disa dokumente që nuk janë sekret afarist.

Nga këto konstatime kundërthënëse, kuptohen qartë tendencat e AK-së dhe jo serioziteti i trajtimit të pretendimeve ankimore dhe shkelja ligjore që është bërë duke mos na lejuar qasje të plotë në ofertën e grupit të OE të rekomanduar për kontratë.

Në lidhje me pretendimet tona ankimore, përkitazi me ofertën e grupit të OE të rekomanduar për kontratë, autoriteti kontraktues nuk ka dhënë përgjigje konkrete e as ndonjë dëshmi për të vërtetuar të kundërtën e pretendimeve tona ankimore, mirëpo me një fjali i ka përmbledhë të gjitha pretendimet tona ankimore se grupi i OE të rekomanduar për kontratë i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe ka ofruar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

Autoriteti kontraktues më tej ka konstatuar se kinse OE ankues nuk ka mundur ti dëshmojë dhe konkretizojë pretendimet ankimore, mirëpo ne e kemi sqaruar se pikërisht për shkak të mos lejimit të qasjes në dokumente nuk kemi mundur të parashtrojmë pretendime me dëshmi konkrete, prandaj mbi bazën e njohurive të përgjithshme për kompanitë në konsorcium kemi ngrit pretendime në këtë mënyrë.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.

AK-së, nëse ka pasur ndonjë dilemë në lidhje me ofertën tonë është dashur të zbatojë nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së dhe të kërkojë sqarime shtesë, sepse vetë diferenca e çmimit është element që nuk mund të eliminohet një kompani automatikisht pa u shfrytëzuar edhe neni 59.2 dhe 72 i LPP-së, prandaj AK-së ka vepruar në mënyrë të njëanshme dhe diskriminuese në raport me kompaninë tonë.

Po ashtu nuk janë respektuar edhe neni 68 dhe 69 i LPP-së, pasi që dëshmitë e ofruara nga grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar dëshmitë sipas këtyre dispozitave, e që janë kërkuar në nenin 8.1&8.2 dhe 9.1&9.2 të FDT-së.

Grupi OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me çmim prej **14,997.840.00 €**, ndërsa ne kemi ofertuar me çmim prej **13, 274.752.02 €**, e që rezulton se ne kemi ofertuar me çmim prej **1,723.088 €**.

Me këtë diferencë të çmimit mund të përfundohen edhe projekte të tjera të rëndësishme për qytetarët, prandaj kërkojmë që të keni parasysh këtë fakt dhe të keni parasysh nenin 6 ekonomikiteti dhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i LPP-së është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve

kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe nenin 7 i LPP-së, sepse ne jemi diskriminuar duke mos na shpallur fitues edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që “Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”.

Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që “Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse”, mirëpo ju nuk i jeni përmbajtur as kësaj dispozite ligjore, pasi që është rekomanduar për kontratë një OE i papërgjegjshëm.

Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

V E N D I M

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE NNP CONTRUCTION & BENI CONSTRUCTION SH.P.K. & DOMID SH.P.K. & 2A GROUP SH.P.K. & 2T SH.P.K.-DEGA NË KOSOVË

ANULOHET, njoftimi dhe vendimi i AK-së për dhënie të kontratës dhe lënda kthehet në RIVLERËSIM,

DETYROHET autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

9. Dëmet materiale

Përshekruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim në vlerë prej 50,000.00 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*

******Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, originalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.***